



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 77

Prishtinë, 01.10.2013. në ora 12:15,

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I takimit të anëtarëve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me deputetët e Këshillit Kombëtar të Republikës Sllovaqe

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, kryetare e Komisionit, Elmi Reqica, Albert Kinoli, Petar Miletij, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jelena Bontiq, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Vesna Mikic

Nga stafi mbështetës: koordinatori i komisionit dhe bashkëpunëtori profesional

Mbledhjen e udhëhoqi: Jasmina Zhivković, kryetare e komisionit.

Deputetët anëtarë të delegacionit të KKRS-së: Prof. Mikuláš Huba, OĽaNO, Ivan Shtefanec, SDKÚ-DS, Juraj Droba, SaS, Jozef Viskupič, OĽaNO, Miroslav Kadúć, OĽaNO, Antonín Cicoň, SMER-SD, Jozef Mikloshko, KDH, Ivan Shvejna, Most-Híd,

Në mbledhje anëtarët e delegacionit propozuan për rend të ditës temën e cila u miratua.

Roli i Komisionit për komunitete dhe vende të rezervuara në strukturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe roli i Komisionit për Komunitete në mbrojtjen e interesave të tyre përmes legjislacionit.

Në fillim të mbledhjes, kryesuesi i Delegacionit të Këshillit Kombëtar të Republikës së Sllovakisë, **Ivan Shtefanec**, falënderoi për pritjen dhe theksoi arsyet e vizitës në Kosovë, duke theksuar interesimin për pozitën e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë,

integrimin e komuniteteve të cilat jetojnë dhe punojnë në Kosovë, rolin e komisionit parlamentar për komunitete dhe vendet e rezervuara në strukturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe rolin e komisionit për komunitete në mbrojtjen e interesave të komuniteteve përmes legjislacionit.

Në vazhdim, kryetarja e komisionit, **Jasmina Zhivković**, përfaqësuese e komunitetit serb dhe deputete e SLS-së i përshëndeti të pranishmit dhe pastaj i informoi deputetët KKRS-së me përbërjen, rolin dhe kompetencat e komisionit të cilat i ka gjatë shqyrtimit të Projektligjit, monitorimin e ligjeve të caktuara në terren, si dhe për strategjitë dhe kompetencat të cilat i përkasin në procesin parlamentar.

Më tej ajo theks të veçantë vuri në drejtim se të gjitha komunitetet janë të interesuara që në mandatet e ardhshme të kenë vende shtesë të rezervuara në bazë të votave të fituara, sepse kjo është mënyra më e mirë e përfaqësimit të interesave të tyre si dhe pjesëmarrja dhe përfaqësimi më i madh në të gjitha sferat e jetës të shoqërisë kosovare.

Kur është fjala për zbatimin e legjislacionit dhe masat mbrojtëse për të drejtat dhe interesat e komuniteteve i cili është i lidhur me shkallën e zbatimit së ligjit për interesat jetike të komunitetit, mund të themi se nuk është e kënaqshme, por ka njëfarë përparimi. Në këtë kontekst, procesi i monitorimit të legjislacionit duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i pa penguar sepse është për interesin e përgjithshëm në fusha të ndryshme të jetës shoqërore në mënyrë që të krijojë shumanshmërinë për të mirën e të gjitha komuniteteve në fushën e ligjeve të gjitha ligjet janë të harmonizuara me standardet evropiane dhe kemi interes të përcjellim miratimin e ligjeve dhe ndikimin e tyre apo shkeljen e të drejtave dhe interesave të komunitetit, ndërsa lidhur me zbatimin e tyre duhet bërë përpjekje maksimale për implementimin e plotë të tyre në praktikë në mënyrë që shumë gjëra do të ishin të zgjidhura .

Petar Miletiq, deputet i SLS-së dhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit nga radhët e komunitetit serb, duke u përgjigjur në pyetjen e delegacionit për sistemin e kuotave u përgjigj se personalisht atë e sheh si korrigjimin e një sistemi të papërsosur e demokracisë në kuptimin që demokracia në kuptimin e saj origjinal nuk është mjafton për të mbrojtur të gjitha pakicat , kështu që ne kërkojmë që të gjithat bashkësitë etnike të kenë të drejtë për vende shtesë. Ne besojmë se në Kosovë duhet të jetë një sistem i kuotës kur bëhet fjalë për komunitetet. Ne nuk jemi të kënaqur se si ligjet implementohen në terren dhe duam që ato të kenë zbatim të plotë për të siguruar se të gjitha komunitetet kanë të drejtat e tyre të plota për të jetuar sikurse jetojnë të gjitha komunitetet në Evropë. Sot, komunitetet dhe sidomos serbët kanë një pozitë shumë më të mirë sesa para 10 viteve , është e rëndësishme të dimë , por ne nuk jemi plotësisht të kënaqur , sepse ajo mund të jetë më mirë. Lidhur me arsimimin e serbëve në Kosovë , ai akoma zbatohet sipas sistemit të Republikës së Serbisë. Prishtina nuk bënë ndarjen e serbëve “ të mirë dhe të këqijë , ” besnikë dhe jolojalë ” atë e bënë Beogradi dhe si dëshmi e kësaj është se Qeveria e Republikës së Serbisë , nga 29 lista serbe në zgjedhjet lokale ka mbështetur dhe përkrahur vetëm një, ndërsa Prishtina asnjërin. e cila është jashtëzakonisht e dëmshme për ndarjen politike të serbëve në Kosovë. Sa i përket popullsisë LGPT në Kosovë nuk flitet por unë jam i sigurt se do të jetë në rendin e ditës dhe do të ketë hapësirë për të luftuar për të drejtat e tyre .

Elmi Reçica , përfaqësues i komunitetit shumicë dhe deputet i PDK-së , tha se vizita e delegacionit ka rëndësi të madhe, ngase vijnë nga Evropa Qendrore . Komisioni nuk bënë ndarje sipas parimit të përkatësisë kombëtare , në të kundërtën , ekziston respekti reciprok dhe një shkallë e lartë etë bashkëpunimit konstruktiv i cili lidhet me pjesën kur Komisioni vendos dhe punon sipas ligjeve . Nuk ka asnjë dyshim se përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve në këtë Komisioni duan të kontribuojnë plotësisht në përmbushjen e mandatit të saj për të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat, interesat dhe mbrojtjen e komunitetit. Ky është një shembull se Kosova është një rast i veçantë ku komunitetet janë më të integruarat në rajon dhe respektimi i të drejtave të bashkësive të cilat janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin ekzistues.

Kemi problem me zbatimin e ligjit për trashëgiminë kulturore, por ai do të jetë objektiv kryesor për t'u përdorur aktivitetet e ardhshme të komisionit për të mirën e të gjithë qytetarëve . Ne si shumicë nuk guxojmë të lejojmë që të abuzohet me marrëveshjen e arritur në mes të Prishtinës dhe Beogradit në plotësimin e të gjitha kriterëve dhe kërkesave që vijnë për motive të ndryshme dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me komunitete..

Nuk është e vërtetë se përfaqësuesit politikë të serbëve në parlament paraqesin vetëm një pjesë e serbëve , por të gjitha vendet ku ata jetojnë dhe kjo është shumë e rëndësishme të ceket.

Müfera Sinik, në emër të GP 6 + theksoi se të drejtat e komuniteteve në Kosovë janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligje. Kushtetuta është e mirë, por ka probleme me zbatimin e ligjit. Ka shqetësime rreth kuotave dhe ne mendojmë se kjo e drejtë nuk duhet të kufizohet. Në Kosovë jetojnë rreth 20.000 turq dhe gjuhën turke e flasin rreth 300.000 njerëz. Në strukturën e nivelit qendror nga radhët e Komunitetit turk i kemi tre ministra, tre zëvendës ministra, ndërsa në nivelin lokal, kryetarin e Komunës së Mamushës, gëzojmë të drejtën për shkollim ... kështu që turqit në Kosovë jetojnë mirë. Si jetojnë pakicat që në Sllovaki, dhe si janë ato të përfaqësuara në shoqëri do të donim të dinim dhe të shohin dhe ftesën për një vizitë studimore në vendin tuaj, ne mirëpresim shkëmbimin e përvojave, njohja e praktikave më të mira parlamentare sa u përket komunitetit dhe zhvillimit e bashkëpunimit ndërparlamentar.

Mursel Halili , si përfaqësues i komunitetit goran GIG tha se në parlamentin e Republikës së Sllovakisë nuk ka vende të rezervuara për komunitete sikurse tek ne. , dhe po të mos ishte kështu ne nuk do të ishim takuar këtu. Kjo është absolutisht e nevojshme për shkak të përfshirjes së të gjitha komuniteteve në jetën politike dhe sociale , kështu që unë mendoj se ne si përfaqësues të komunitetit goran se Kosova ka legjislacionin e vet dhe kjo qasje ka bërë shumë në drejtim të pjesëmarrjes dhe promovimit të të gjitha komuniteteve. Komuniteti Goran gjatë këtyre viteve është i pranishëm dhe unë mendoj se disi plotëson nevojat e veta. , por ende ka hapësirë ku ata mund të realizojnë të drejtat e tyre si qytetarë dhe të jenë të barabartë me të tjerët.

Ekzistojnë mekanizmat për të monitoruar ligjin dhe ka fleksibilitet të madh në arsimim dhe të drejta kulturore dhe ka mundësi që këto fusha të përsosen. Sigurisht, si një komunitet ne jemi shumë të interesuar në procesin e mëtejshëm të decentralizimit të dhe ne iniciojmë çështjen për formimin e komunës së Gorës për të përmbushur të gjitha të drejtat tona .

Albert Kinoli, përfaqësues i komuniteti Rom dhe deputet i GP 6+ theksoi nevojën për një bashkëpunim të tillë, falënderoi për interesimin e treguar për pozitën e komuniteteve dhe se komuniteti Rom në Kosovë ka pozitë favorizuese për dallim nga shtetet tjera në regjion në lëmin e arsimimit, integritetit dhe përfaqësimit në sistem

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

**Procesmbajtës,
Njësia e komisionit parlamentar**

Kryetarja e Komisionit,

Jasmina Zhivković